



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTËSE

Nr.2295 Prot.

Lezhë, më , 22 .02.2022

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
KATEGORIA EKZEKUTIVE**

**Lloji i diplomës “Shkenca Juridike/Shkenca Shoqërore”
Niveli minimal i diplomës “Bachelor”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhen e proves dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Planit të Pranimeve në Shërbimin Civil të vitit 2022, miratuar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.111, datë 02.02.2022, Bashkia Lezhë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil, kategoria ekzekutive për pozicionin:

- 1. Specialist në Sektorin e Evropës, Ndihmës së Huaj, Diasporës dhe Migracionit, Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, në Bashkinë Lezhë, Kategoria IV-a.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil)

aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: Lëvizje paralele	03.03.2022
--	-------------------

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: Pranim në shërbimin civil	08.03.2022
---	-------------------

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Angazhohen në përgatitjen e raporteve, planeve dhe dokumentimin e punës sipas pozicionit.
2. Angazhohen në hartimin, monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e dokumenteve strategjike dhe projekteve të zhvillimit social-ekonomik afatgjatë dhe afatmesëm të Bashkisë në përputhje me planet vendore, kombëtare dhe rajonale për zhvillimin e komunitetit.
3. Bën kërkime, evidenton nevoja dhe ofron rekomandime për mundësitë e zhvillimit social - ekonomik lokal.
4. Krijojnë sistemin e informacionit dhe bazën e të dhënave për kërkesat dhe ankesat e qytetarëve.
5. Administrojnë dhe monitoron transparencën e pushtetit vendor.
6. Të evidentojnë, studiojnë dhe organizojnë punën për zbatimin e ligjeve dhe akteve të ndryshme nënligjore, të cilat rregullojnë marrëdhëniet me organizma homologe të huaja, persona juridikë e fizikë, shtetërorë e privatë, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike, kulturore e sportive, arsimore e shëndetësore në territor ose në interes të bashkisë;
7. Ndihmojnë nëpunësit e bashkisë në planifikimin dhe organizimin e vizitave dhe të veprimtarive me jashtë, duke ndjekur të gjithë procedurën e kërkuar;
8. Për çdo aktivitet që pritet të organizohet ose pas përfundimit njofton rregullisht me shkrim eprorin, titullarin e institucionit dhe sipas kërkesave Këshillit Bashkiak;

9. Për pritje-përcjelljet e delegacioneve të huaja që vijnë për vizitë në bashki, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës përgatit relacionin dhe preventivat përkatës të shpenzimeve;
10. Harton projekt-buxhetin e sektorit për vitin pasardhës dhe ndjek ecurinë e tij;
11. Përgatit projekt-marrëveshje dhe protokolle të ndryshme rreth bisedimeve që bëhen me delegacione të huaja;
12. Evidenton të gjithë personat e huaj, shoqatat, fondacionet etj., të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë. Për evidentimin e tyre bashkëpunon edhe me komisariatit e policisë;
13. Mbështetja dhe drejtimi i strukturave administrative të bashkisë për përgatitjen e projekteve në kuadër të programeve të asistencës së Bashkimit Evropian si dhe informimi i qartë dhe në kohë për Thirrjet për Aplikime të shpallura në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Territorial të BE-së;
14. Mban në evidencë subjektet e huaja, të cilat ushtrojnë aktivitet në qytetin e Lezhës, ndjek problemet dhe ndihmon në mbarëvajtjen e punës së tyre;
15. Kërkon nga çdo grup pune që kryen vizita jashtë shtetit relacionin e shërbimit të kryer dhe informon për këtë titullarët e bashkisë, dikasteret përkatëse, si dhe Këshillin e Bashkisë sipas kërkesës;
16. Mban kontakte me partnerë të tretë lidhur me zbatime në mbështetje të fushave që mbulon sektori;
17. Evidenton dhe prezanton nevojat për ngritjen e kapaciteteve të stafit kur është e nevojshme .

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori, (sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar) (niveli i pagës IV-a),
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkenca Juridike/Shkenca Shoqërore. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- c) Të ketë eksperience punë mbi 2 vite në administratën shtetërore ose vendore

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Lezhë, dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 03.03.2022.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **07.03.2022** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Lezhë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të bashkisë, listën paraprake të kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të, [nëpërmjet adresës tuaj të e-mail](#), për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” ;
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”;
- g) Njohuritë mbi VKM Nr. 450, datë 26.7.2018 – “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- h) Njohuritë mbi VKM Nr. 734, datë 9.9.2015 “Për Rregullimin e Veprimtarisë me Jashtë të Administratës Shtetërore”.

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Lezhë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunesit civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- d) Të jetë shtetas shqiptar;
- e) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- f) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- g) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- h) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- i) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkenca Juridike/Shkenca Shoqerore .(*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 08.03.2022, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, pranë Bashkisë Lezhë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **18.03.2022**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Lezhë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në faqen zyrtare të bashkisë, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- d) Ligjin Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” ;
- e) Ligjin Nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
- f) Ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”;
- g) VKM Nr. 450, datë 26.7.2018 – “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet qeverisjes qëndrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- h) VKM Nr. 734, datë 9.9.2015 “Për Rregullimin e Veprimtarisë me Jashtë të Administratës Shtetërore”.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Lezhë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e saj zyrtare. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit ne Shërbim Civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Bashkisë Lezhë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data **18.03.2022**.

KRYETARI
Pjerin Ndreu